



BULETINI INFORMATIV

QERSHOR

2025



Vendimmarrjet e Bordit të ERE gjatë muajit qershor

Gjatë muajit qershor 2025, Bordi i ERE zhvilloi katër mbledhje vendimmarrëse, ku u shqyrtuan dhe miratuan 17 vendime në funksion të zhvillimit dhe rregullimit së tregut të energjisë.

Licencime të reja

Shoqëria "GREEN ENERGY" shpk u licencua nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Qarkun Fier që pritet të nisë operimin brenda datës 01.06.2026.

Në konsultim publik:

1. Komentet e AREA-s në lidhje me vendimin e ERE-s për ndryshime në kontratën e PP me FTL sipas propozimit të bërë nga FTL (komentet datë 13.06.2025).
2. Komente të shoqërisë "Gen - I Tirana" shpk në kuadër të procesit të konsultimit publik për kontratën e KESH - FSHU për shitjbljerjen e energjisë elektrike për vitin 2025.

Publikime

Në linkun <https://shorturl.at/paKYL> do të gjeni të publikuar të dhënat e tregut të energjisë për 4-mujorin e vitit 2025, raport në të cilin janë pasqyruar statistika mbi prodhimin vendas, (hidro, diellor, eolik), importet - eksportet, si dhe nivelin e konsumit dhe humbjeve në rrjet. Ky raportim analizon gjithashtu përqindjet e pjesëmarrjes së secilit burim energjie, tendencat e volumit të tregtuar dhe indikuesit kryesorë të performancës së tregut elektrik shqiptar gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2025.

www.ere.gov.al

0800 23 23

Procedura të filluara gjatë muajit qershor

Gjatë muajit qershor, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) filloi procedurat për licencimin e shoqërive:

- "Energovia.Albania" shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.

- "EZ-5 ENERGY" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrale fotovoltaik, për shoqëritë "EZ-5 ENERGY" shpk me kapacitet të prodhues 30 MW, - "IDI 2005" shpk me kapacitet prodhues 8.8 MW, si dhe "FIER THERMOELECTRIC" sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga termocentrali, me kapacitet të instaluar 170 MW.

Në përputhje me "Rregulloren për procedurat, dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar, ERE për të gjitha këto aplikime vijoi me publikimin në median e shkruar dhe marrjen e objeksioneve.

Autorizime për garanci financiare

Bordi miratoi kërkesat e disa shoqërive për vendosjen e kuotave apo aseteve si garanci (hipotekë) apo transferimin e aseteve fikse ndaj institucioneve financiare, për të mbështetur investimet apo aktivitetet tregtare. Në këtë kuadër u miratuan autorizime për shoqëritë "PARISOL" sh.p.k dhe "GreeNNat Solar Park Ballsh" sha.

Vendime të tjera

Përfundoi procedura administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 24.04.2025, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "SELISHTË" shpk", pasi shoqëria e ka shlyer plotësisht debinë e saj në datën 03.06.2025, brenda afatit 30-ditor të publikimit të në Fletoren Zyrtare të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 87/2025, për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

U miratua Garancia e Origjinës për "Nova Solar System" shpk për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik Nova Solar System, për periudhën 30.07.2024-30.09.2024.

U rishikua vendimi nr.283, datë 18.12.2024, për "Mountain's Green Energy" shpk, pas përmbushjes së kushteve teknike nga ky subjekt.

BULETINI INFORMATIV

QERSHOR**2025**

Vendime për çmimet dhe tarifat

Në mbledhjen e datës 9 qershor, Bordi miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike për muajin maj 2025 nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët në nivelin e tensionit 35 kV, në vlerën 11.88 Lekë/kWh.

Gjithashtu në mbledhjen e datës 27 qershor, u miratua një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s NR. 112, datë 23.05.2025 “Mbi përlllogaritjen e pagesave rregullatore të vitit 2025”, sipas të cilit në listën e të licensuarvesubjekt i pagesave të rregullimit shtohet “Energia Gas and Power Albania”.

Seanca dëgjimore me palët e interesit

Gjatë muajit qershor, ERE organizoi 5 seanca dëgjimore me konsumatorë dhe subjekte të licencuara. Çështjet e adresuara përfshinin:

Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe operatorëve (FSHU, OSSH).

Sqarime me subjekte të licencuara në lidhje

me aplikimet e tyre për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e e barrës siguroese mbi kuotat e shoqërive.

Filloi shqyrtimin për miratimin e disa akteve rregullatore:

■ “Rregullores për Alokimin e Kapaciteteve Afatgjatë”

Projekt-rregullorja synon të krijojë një kornizë të harmonizuar për alokimin ndërkufitar të të drejtave të transmetimit në periudha afatgjata, përmes metodologjive të harmonizuara dhe ankandeve të përbashkëta evropiane. Ajo përfshin rregulla për llogaritjen dhe ndarjen e kapaciteteve, zhvillimin e ankandeve, kompensimet dhe rikuperimin e kostove. Zbatimi i kësaj rregulloreje është një hap i rëndësishëm drejt integritetit të Shqipërisë në tregun rajonal dhe evropian të energjisë elektrike, duke rritur transparencën, efikasitetin dhe sigurinë e tregut afatgjatë.

■ “Udhëzuesit për Balancimin e Energjisë Elektrike”

Ky udhëzues vendos rregulla për mënyrën e planifikimit, prokurimit, aktivizimit dhe shlyerjes së rezervave të balancimit nga Operatorët e Sistemeve të Transmetimit (OST), për përdorimin e rezervave zëvendësuese

në rast të pamjaftueshmërisë së burimeve ekzistuese të balancimit, si dhe përfshin dispozita për shkëmbimin ndërkufitar të energjisë së balancimit, format e pjesëmarrjes në treg për të gjithë aktorët përkatës dhe

detyrime për bashkëpunim dhe raportim të të dhënave, me qëllim rritjen e transparencës dhe funksionimin e qëndrueshëm të tregjeve.

U vendos zgjatja e afatit të zbatimit të intervalit 15 minuta në Tregun e Balancimit deri më 31.12.2025.